



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:107269

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05551951

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.427/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit I. K. , i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.906/2022 të datës 26.05.2022 për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.2, lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 03.04.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, te pandehurit I. K. , me datë 03.04.2024 shpalli, ndërsa me datë 04.04.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

I. K. , i biri i D. dhe nënës S.e gjinsë F., i lindur më ..... në Pejë, ku edhe banon në rri “Y. B.” nr. ..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme teknike, punon në ndërtimtari, i identifikuar në bazë të nr. personal ....., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datë 06.05.2022, rreth orës 12:20 në autolarjen “Dini” në rrugën “K. e B.” në Pejë, me dashje me mjet të rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndim të rëndë trupor, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit E. I., në atë mënyrë që, dhe gjersa i pandehuri kishte shkuar tek autolarja e

të dëmtuarit në vendin e lartcekur aty fillon një konfrontim verbal në lidhje me një motoçikletë dhe ngjarja rrjedh si në dispozitivin I, ku gjatë kësaj kohe i pandehuri I. me brisk që e nxjerr nga gjepi e godet të dëmtuarin në kraharorin e djathtë, ku nga kjo goditje i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore-plagë shpuese në rexhionin e krahut të djathtë,

- me çka ka kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par. 2, lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

## GJYKON

Të pandehurit I. K. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (vitesh) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- III. I dëmtuari udhëzohet qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

## ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 26.05.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.906/22, kundër të pandehurit I. K. për shkak

të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.2, lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Fillimisht kjo lëndë sipas akuzës bazë është iniciuar kundër dy personave dhe atë të pandehurit E. I. dhe të pandehurit I. K. , mirëpo për shkak se nuk kemi mundur që të sigurojmë prezencën e të pandehurit E.I., dhe pas marrjes së mendimit të palëve të tjera gjykata në kuptim të nenit 35 të KPPRK-së e bëri veçimin e procedurës për të pandehurin E. I. j ndërsa vazhdoi procedimin për të pandehurin I. K. .

Kjo gjykatë me datë 03.04.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, dhe i pandehuri I. K. , në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht e pas konsultimit me mbrojtësin e tij, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimi të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurorja e shtetit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi “ Pasi i pandehuri pranoi fajësinë e ky pranim fajësie gjen mbështetjen në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tersi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpalle fajtorë, ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethana lehtësuese, ndërsa fakti se për kryerjen të veprës penale është përdorë mjet i rrezikshëm ky fakt të merret si rrethanë renduese”.

I pandehuri I. K. deklaroi “ Më vjen keq që ka ndodhë ky rast, nuk kisha dashtë me ndodhë asnjëherë dhe premtoj se nuk do të përsëritet në të ardhmen”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat

38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese te çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin si rrethanë renduese nuk kemi, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe ndjehet keq dhe i penduar për rastin, hera e parë që ka ra ndeshë me ligjin, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së, gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit I. K. do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit I. K. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë

kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata vendosi që të demtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest të rregullt civil, e kjo duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.427/22, me datë 04.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale:  
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.